

*Hysen AZEMI*

**PROCESVERBAL I MARRJES NË PYETJE TË  
ZHUK (HAXHI) ÇELËS**

**Punuar në zyrën e Drejtorisë Qarkore të Drejtoratit të Sigurimit Shtetëror (UDB-së) në Pejë, më 5-II-47.**

Quhem ZHUKË ÇEL HAXHIA, emri i babës Haxhi dhe i nënës Dronde Fazli Selmani nga fshati Vuthaj, komuna e Gucisë, rrethi i Andrijevicës, Mali i Zi. Me profesion, bujk. Jam i lindur në fshatin Stankaj (Joshanicë), KPK (Këshilli Popullor i Komunës) Kuqishtë, rrethi i Pejës. Jam 60 vjeç, nënshetatats i RFPJ (Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë), shqiptar i konfesionit mysliman. Flas shqip dhe nga pak serbisht. Nuk di të shkruaj, as emrin tim nuk di ta nënshkruaj. Jam i martuar tri herë. Dy gra më kanë vdekur e një e kam gjallë. Gruaja e parë e ka pasur emrin Hava Bektesh Zymberi nga fshati Staradaran, KPK Gjurakoc. Me të kam pasur 5-6 fëmijë, prej të cilëve tash e kam djalin Binakun dhe vajzën Ajshen e martuar me Azem Berishën në fshatin Ruhot. Gruaja e dytë, e cila më ka vdekur, e ka pasur emrin Bikë, e bija e Adem Isufit nga fshati Shtupel i Vogël. Me këtë kam pasur tre fëmijë: dy vajza: Begijen e Nuriyen dhe një djalë Halilin. Këta janë të vegjël. Gruaja e tretë, që është gjallë, quhet Sutë dhe është e bija e Arif Bajraktarit nga fshati Arzhanicë e Epërme, KPK Velikë, rrethi i Andrijevicës. Me të kam katër fëmijë: dy djem e dy vajza, quhen Rabë e Tale dhe Shaban e Qerim. Në familje kam 34 anëtarë. Nuk kam shërbyer në asnjë ushtri. Nuk kam qenë kurrë në gjyq.

Para fillimit të marrjes në pyetje, të përmendurit i është tërhequr vërejtja që ta thotë të vërtetën dhe se, përndryshe, do të përgjigjet për mashtrim.

Pyetjeve të bëra u është përgjigjur:

*\* Me çka je marrë në kohën e Jugosllavisë, cila partive u ke takuar dhe kur?*

- Para ardhjes në pushtet, jam marrë gjithnjë me bujqësi në shtëpinë time. Kur jam bërë rreth 30 vjeç jam bërë i zoti i shtëpisë. Në Rugovë, para meje, kryetar komune ka qenë Shaban Rexha, nja shtatë a tetë vjet. Më duket se ka qenë deri në vitin 1930. Pas tij, kur janë mbajtur zgjedhjet, kryetar jam zgjedhur unë. Ndoshta këtu mund të gaboj për sa u përket viteve. Nuk më kujtohet tamam, por më duket se kryetar në Rugovë kam qenë 5-6 vjet. Me mua kanë qenë si kryepleq në komunë Scekë Husa dhe Bekë Zhuja. Mandej kryetar ka qenë Bekë Zhuja, të cilin e ka vrarë Rizë Zymberi. Pas meje kryetar ka qenë Hilmi Begu e pas tij, si thashë, ka qenë Bekë Zhuja.

Kur kam qenë kryetar, i kam takuar Partisë Demokratike. Atëherë, me sa më kujtohet, deputet ka qenë njëfarë Sokiqi nga Beogradi. Pas tij, njësoj si demokrat, në vend të Sokiqit, ka qenë Sefedin Begolli, e këtë e ka zëvendësuar Jojiqi nga Peja. Të gjithë këta kanë qenë demokratë dhe unë kam qenë gjithnjë me ta. Si demokratë, nuk guxonim të punonim haptazi, por fshehtas. Një herë më ka lidhur xhandarmeria, më kanë kërcënuar dhe shumë herë më kanë ardhur në shtëpi dhe më kanë thënë se nuk guxoj të agjitoj. Me mua në Rugovë ka qenë si demokrat Isuf Mehmet Bajraktari nga fshati Shtupel i Vogël. Nga detyra e kryetarit jam pushuar kur deputet në Pejë ishte Nedelko Simonoviq, nga rrethi i Istogut, i cili ishte radikal. Tërë pushteti ishte në duart e mbretit Aleksandër. Atëherë jam pushuar nga detyra me urdhrin e Banovinës dhe pa kurrfarë zgjedhjesh. Pas pushimit nga detyra çdo të tretën ditë më vinte në shtëpi xhandarmeria dhe kontrollonte ku isha.

Prej pushimit nga detyra e kryetarit nuk kam qenë më kurrkund në pushtet, por tërë kohën kam ndenjur në shtëpi dhe jam marrë me bujqësi.

*\* Ku ke qenë me rastin e kapitullimit të Jugosllavisë dhe çka ke bërë më vonë pas ardhjes së ushtrisë fashiste?*

- Kur ka kapitulluar Jugosllavia kam qenë në shtëpinë time me anëtarët e familjes në fshatin Lutogllavë. Një natë para kapitullimit të Jugosllavisë kam qenë i thirrur nga xhandarmeria që të shkoja natën në Pejë dhe se më thërriste një kolonel që atëherë gjendej në Pejë. Më kanë marrë natën, kundër vullnetit tim, dhe më kanë thënë se duhet të merrem vesh me të gjithë njerëzit e shquar të Rugovës që të mos u ndodhë asnjë e keqe civilëve, sepse këndej do të kalojë ushtria dhe duhet të ketë qetësi. Të gjithë kryepleqtë janë thirrur në Pejë dhe kjo u është thënë personalisht secilit. Atëherë kryetar komune ishte Osman Rustemi, nga fshati Drelaj. Bashkë me kryetarin atëherë ishin kryepleqtë e fshatrave Isuf Mehmeti nga fshati Shtupel i Vogël, Haxhë Zeka nga fshati Shtupel i Vogël, Din Zeka nga fshati Reka e Allagës, Rustem Veseli nga fshati Repicë, Rexhep Mustafa nga fshati Malaj, Hysen Syla nga fshati Boge, Sokol Çeli, vëllai im, nga fshati

Stankaj, Agan Seka nga fshati... Fazli Zymberi nga fshati Kuqishtë, Tahir Abazi nga shati Drelaj, i cili ka vdekur.

Të lartpërmendurit, që atëherë ishin kryepaq të fshatrave, i ka thirrur nënprefekti i rrethit, kurse mua më ka thirrur koloneli i ushtrisë. Nënprefekti u ka thënë atyre se rruga duhet të jetë e sigurt.

Atëherë, unë ndonjëherë rrija në shtëpi në Lutogllavë e ndonjëherë në Pejë. Në ato momente, populli, të shumtën malazeztë, kanë filluar të largohen dhe të kalojnë matanë Rugovës. Kanë qenë, si më thoshin, rreth 30.000 burra, gra e fëmijë.

**Mori në pyetje – togeri**  
**Alo Avdiq (d.v.)**

**Shenja e gishtit**  
**Zhukë Haxhia**

**Punuar në zyrën e Drejtorisë Qarkore të Drejtoratit të Sigurimit Shtetëror (UDB-së) në Pejë, më 27 shkurt të vitit 1947.**

## **PROCESVERBAL MBI MARRJEN NË PYETJE**

Të të pandehurit Zhukë Haxhia nga Rugova, Pejë, fshati Stankaj. Të përmendurit më parë iu tërhoq vërejtja që ta thotë të vërtetën dhe ai deklaroi: gjeneraliet si në procesverbalet e mëparshme:

*\* A e njeh Imer Berishën, Ndue Përllëshin, Demë Ai Pozharin, Adem Shabanin, Ramë Mujën?*

- Unë njoh vetëm Demë Alinë dhe Ramë Mujën e Adem Shabanin, kurse Imer Berishën dhe Ndue Përllëshin nuk i njoh. Demë Alinë e kam njohur edhe më parë. Derisa kam qenë në mal e kam parë një herë në malin "Ravninë", sepse ai kishte ardhur te ne për t'u fshehur me djalë të vet. Ramë Mujën e kam parë në Lug të Gashit kur ishim nisur për t'u kthyer në terrenin tonë me rastin e kthimit nga Malësia. Ramë Shabanin e kam njohur sepse e kam pasur fqinjë.

*\* A ka mbetur te ju Demë Alia kur ka pas ardhur me të birin që të fshihej?*

- Nuk ka ndenjur sepse nuk mund ta prananim.

*\* A e ke njohur Islam Tabakun?*

- Po, e kam njohur qysh përpara por dhe më vonë kur kam qenë në mal. Islami ka ardhur te Riza Zymberi në mal kur ka ikur dhe gjithnjë ka qenë me Rizën.

\* *A ke biseduar me të?*

- Po, ai më ka treguar pse ka ikur në mal dhe më ka treguar se ka bashkëpunuar me gjermanët.

\* *Me kë jeni takuar kur keni qenë në terrenin e Shqipërisë dhe a ka qenë ndonjë i huaj, dhe pse po thua jo kur jeni takuar me anglezët?*

- Nuk jam takuar me ata.

\* *A e ke njohur Muharrem Bajraktarin?*

- Nuk e njoh.

\* *Si keni mbajtur lidhje me të?*

- Nuk kemi pasur kurrfarë lidhjeje me të.

\* *A e njeh Pashuk Bibën?*

- Pashukun nuk e njoh, por e njoh vëllanë e tij, Kolën, i cili ka qenë ministër në kohën e okupacionit.

\* *Si keni jetuar në Shqipëri?*

- Kur ishte dimër fshiheshim në strehimore ndaras.

Riza e kishte strehimoren e vet nja tri orë larg strehimores sonë.

\* *A ke qenë ti në strehimoren e Rizës?*

- Unë nuk kam qenë, por Riza ka qenë në strehimoren tonë vetëm një herë.

\* *Si quhen fshatarët që ju kanë dhënë ushqim?*

- Riza Zymberi siguronte ushqim për ne të gjithë. Ai kishte miq të mirë aty sepse në ato vise kishte jetuar para se të ikte në mal.

\* *Si u bë që Riza vinte te ti e ti nuk shkoje tek ai?*

- Unë nuk kam shkuar tek ai sepse kishte borë e pasi unë jam i vjetër nuk mund të shkoja tek ai, por afërsisht e kam ditur vendin ku gjendej strehimorja e tij.

\* *Te kush ka ardhur Manush Begu në Rugovë?*

- Tek unë e kanë sjellë dy fshatarë, të cilëve nuk ua di emrat, vetëm e di se kanë qenë nga fisi Kastriot. Unë e kam mbajtur rreth dy javë. Mandej kam biseduar me Riza Zymberin dhe ai e ka dërguar te Sali Mani në Shqipëri. Begu ka qenë i sëmurë kur është nisur për në Shqipëri. Pas dy muajve, Riza më ka thënë se Manush Begu ka vdekur dhe se e kanë varrosur.

\* *Sa herë jeni takuar me bandat nga rrafshi?*

- Nuk jemi takuar fare.

\* *A ke dëgjuar ndonjëherë diçka për ato?*

- Nuk kam dëgjuar kurrëgjë.

\* *A ju ka ardhur juve ndonjë direktivë me anë të Islam Tabakut ose ndonjë personi tjetër nga ana e “Këshillit të të Dymbëdhjetëve”?*

- Nuk na ka ardhur kurrëgjë dhe as që di diçka për këtë.

\* *Pse po thua jo kur ke marrë direktiva dhe je pajtuar me to?*

- Kjo nuk është e vërtetë.

\* *Na trego çka ke biseduar atë mbrëmje kur je takuar me Ramë Mujën?*

- Ramë Muja më ka treguar sa se edhe ai ka punuar për komunizmin dhe se më vonë nuk i ka pëlqyer ajo linjë dhe është arratisur në mal, e ka ndryshuar politikën dhe ka punuar kundër rendit të ri.

\* *Prejse je arratisur në mal dhe derisa ke shkuar në Shqipëri na trego me kë ke lëvizur dhe me kë ke qenë?*

- Prejse kam ikur në mal e derisa kam shkuar në Shqipëri kam lëvizur në terrenin e Rugovës, pos një herë kur kam shkuar të takohem me Demë Alinë. Për nga numri nuk kemi qenë kurrë më shumë se 10 veta. Kështu ka qenë derisa jemi nisur për në Shqipëri.

\* *Na trego tash për rrugën nëpër të cilën je nisur për në Shqipëri?*

- Jemi nisur nga vendi “Qafa e Muragasit”, e kemi kaluar Bistricën dhe kemi mbërritur në Nicinat. Nga Nicinati kemi ardhur te Lugu i Shkodrës e prej aty te “Huni i Magjupit”, mandej nëpër male kemi ecur natën dhe agimi na ka zënë në tëbanat e Gashit në Shqipëri. Prej armëve kemi pasur vetëm pushkë dhe asgjë tjetër.

\* *Si guxon të thuash se keni qenë vetëm rreth 10 veta, kur neve na janë dorëzuar tashmë njëzet e disa persona me anë të Sali Manit, e që kanë qenë nga ai grupi juaj? Në këtë grup ka qenë edhe djali yt?*

- Këta janë nisur vetëm dhe nuk kanë qenë në grupin tim. Ata janë nisur me anë të të njohurve të Sali Manit dhe të Rizë Zymberit.

\* *Kur janë dorëzuar këta, pse nuk je dorëzuar atëherë edhe ti? Cili ka qenë qëllimi juaj që keni shkuar aq larg që të intervenoni tek Enver Hoxha?*

- Neve kjo na është dukur më vështirë sepse ndiheshim më shumë fajtorë dhe nuk guxonim të dorëzoheshim pa garancinë e Sali Mani. Sali Mani ishte nisur për në Tiranë. Ne kemi pritur që të kthehej ai dhe pasi ai nuk u kthye ne vendosëm të mos dorëzohemi.

*\* Pse ka intervenuar aq shumë Sali Mani për ju?*

- Sepse Riza Zymberi më herët ka qenë 20 vjet në arrati në atë territor, aty ishte strehuar dhe kishte miqësi të madhe me Sali Manin.

*\* A keni pasur farë përlëshjesh me partizanët në terren?*

- Nuk kemi pasur kurrfarë përlëshjesh.

*\* A keni dëgjuar për gjykimin e Bernard Llutit, Kolë Parubit e të tjerëve?*

- Nuk kemi dëgjuar kurrgjë.

*\* A është zënë në ndonjë rast dikush nga grupi juaj?*

- Nga 6 a 7 njerëz që kanë ecur me mua asnjëri s'është zënë, e për të tjerët s'di.

*\* A ke dëgjuar për gjykimin e disa personave që ne i kemi zbuluar?*

- Nuk kam dëgjuar kurrgjë.

Nuk kam se çka them tjetër. Deklarata e sipërme më është lexuar dhe e pranoj tërësisht si timen dhe këtë e vërtetoj me shenjën e gishtit tim.

**E mori në pyetje  
Mazlum Nimani (d.v.)**

**I fajësuar  
Shenja e gishtit  
(Zhukë Haxhia)**

## **VAZHDIM I MARRJES NË PYETJE TË ZHUK HAXHISË**

*Si janë zhvilluar gjërat menjëherë pas ardhjes së gjermanëve e pak më vonë italianëve në Pejë, trego çfarë masash dhe me urdhër të kujt i keni ndërmarrë masat për vendosjen e rendit e të qetësisë?*

- Derisa ishin këtu, gjermanët nuk na kanë thirrur, por, pas ardhjes së italianëve, ne jemi mbledhur shumë herë. Vinin përfaqësuesit e Qeverisë Shqiptare, mëkëmbësi i Shqipërisë, ministrat, Bedri Pejani, Qerim Begu e të tjerët. Me bejlerët dhe njerëzit e tjerë të shquar kemi mbajtur shumë konferenca. Unë, si njeri i pashkollë, nuk i kam mbajtur në mend paraqitjet e

programit të tyre. Në tubim kanë marrë pjesë gjithmonë masat nga të gjitha anët. Fshatarët zakonisht i përfaqësonin kryepleqtë, kurse komunat kryetarët e komunave dhe njerëzit e tjerë autoritativë. Në atë kohë u formua Komiteti. Kryetar i Komitetit në Pejë u bë Qerim Begu. Organizator kryesor ishte Bedri Pejani. Në Komitet nga secila komunë hynin nga një ose dy njerëz. Komiteti kishte sektorët e vet dhe njëri prej tyre ishte sektori ushtarak, i cili kujdesej për ushtrinë. Unë nuk e di kush ka qenë gjithsej anëtar i Komitetit, vetëm e di dhe konfirmoj se nga Rugova nuk ka qenë asnjë. Ne rugovasis kemi marrë përsipër ruajtjen e kufirit. U emëruan 6 kapobandë dhe kufiri u nda në sektorë. Për më shumë se 6 muaj unë kam qenë komandant i të gjithë sektorëve.

Pas meje ka qenë Rizë Zymberi, ai përgjigjej politikisht. Te ne gjithmonë ka qenë nga një instruktor kapiten i ushtrisë së rregullt shqiptare i cili na sillte edhe rrogat. Pas 6 muajve unë kam qenë i barabartë me kapobandët e tjerë dhe e kam pasur sektorin Gllogjan - Javorak. Rrogën e kam pasur 20 napolona - sa mermin edhe të gjithë të tjerët. Urdhrat i merrija drejtpërdrejt nga koloneli. Sektorët i kemi ndarë në mbledhjen në Kuqishtë. Aty kanë marrë pjesë një kolonel e një major italian dhe një kapiten shqiptar.

Koloneli ka mbajtur fjalim mbi ruajtjen e kufirit nga malazezët. Secili nga ne zgjodhi nga një sektor afër fshatit të vet. Mua vetëm nuk më kanë thirrur kurrë. Të gjithëve na thërrisnin veç e veç. Na thërrisnin për të referuar për gjendjen në kufi dhe për zbatimin e urdhrave. Italianët e furnizonin Komitetin me armë e ushqime. Gjatë luftimeve vullnetarët zbritnin më së largu deri në Shekullar dhe kanë marrë pjesë në shkatërrimin e Shekullarit e të shekullarasve. Urdhrit për djegien e Shekullarit e kanë dhënë koloneli italian dhe kapiteni shqiptar i quajtur Biba. Kam dëgjuar për vrasjen e grave e të fëmijëve. Thoshin se kështu kanë bërë SS-ët e jo njerëzit e mi.

Për vrasjen e 12 partizanëve derisa ne kishin sektorët tanë di dhe kam dëgjuar, por nuk di kush i ka vrarë dhe sa kanë qenë e as nuk di kush më ka treguar as ku kanë dashur të shkojnë.

*\* Sa herë ke ardhur ti me vullnetarët e tu në Pejë?*

- Kam qenë dy ose tri herë. Për çdo herë kanë ardhur të gjithë kapobandët me nga 50 vullnetarë. Rizë Zymberi, Sali Rama, Haxhë Mustafa, Isuf Mehmeti, Sakë Fazlia dhe unë. Ata na thërrisnin kur vinin ministrat. Ne rinim aty nga dy-tri ditë për sigurimin e tyre dhe, sipas urdhrat, ktheheshim në pozita. Na thërrisnin edhe me anë të komunës. Atëherë kryetar ishte Zhuj Keri. Unë nuk di se vullnetarët e mi kanë burgosur e kanë vrarë.

*\* Na trego si janë zhvilluar gjërat prej çlirimit e deri me ikjen tënde në mal, ku ke qenë, me një fjalë, punën dhe lëvizjen tënde deri ditën e dorëzimit?*

- Pas ardhjes së UNÇ-së te ne në Rugovë ka ardhur Emrush Myftari. Të gjithë ne jemi tubuar në Kuqishtë dhe me bajrak e armë kemi zbritur në Pejë. Aty kemi marrë lejet e nevojshme për qarkullim të lirë. Pas një kohe të shkurtër, kanë ardhur për vendosjen e pushtetit Shaban Rexha, Nexhip Begu etj. dhe mua më kanë emëruar kryetar. Kam qenë kryetar një muaj e disa ditë. Mandej kanë ardhur përsëri disa partizanë dhe kanë mbajtur një konferencë në të cilën më kanë thënë se nuk mund të jem më kryetar e në vend timin e kanë emëruar Sylë Mehmetin.

Mandej është bërë bastisja e Rugovës dhe, kur janë vrarë 7 burra te Shtupeli i Vogël, ne jemi frikuar dhe kemi ikur. Më parë jemi takuar ne ish-kapobandët dhe kemi biseduar se nuk guxojmë të shkojmë më në Pejë pasi kishim dëgjuar se disa njerëz ishin në rrezik dhe kështu ishim përgatitur për të ikur në mal. Shaban Rexha dhe Ivan Veskoviç na thirrën që të paraqitemi. Aty, tek ata në Drelaj, kemi shkuar unë dhe Sali Rama. Ne thamë se do të dorëzoheshim, por se duhej ta gjenim Rizën e të tjerët. Ne i gjetëm shokët tanë, por Riza tha se nuk guxojmë të dorëzohemi pasi nuk kishin ardhur të na thërrisnin ata më kryesorët e nuk guxonim të binim në dorë në bazë të fjalës së Ivan Veskoviçit dhe të Shabanit.

Kështu ne fshiheshim në grupe. Me mua ka qenë rregullisht Bekë Rexhepi. Jemi takuar shpesh, por kishte raste kur edhe nga një muaj nuk dinim njëri për tjetrin. Kështu silleshim nëpër malet e Rugovës deri me daljen në Shqipëri.

Shkuarja jonë në Shqipëri është zhvilluar kështu: Para shkuarjes sonë, Riza Zymberi na ka folur për miqësinë e tij me Sali Manin. Morëm vendim që Riza të angazhohej për kalimin tonë në Shqipëri. Riza shkoi dy herash atje dhe, 5 ditë pas kthimit të tij, erdhi një letër nga Sali Mani. Në letër shkruante sa Sali Mani ishte në gjendje ta rregullonte çështjen tonë, do të thotë t'i strehonte 5 a 6, e nëse do të dorëzohej ai, do t'ia rregullonte qëndrimin e lirë në Shqipëri ose ta kthente në Jugosllavi. Letrën nga Sali Mani e solli Imer Maliqi nga Nokshiqi. Kështu, një ditë në gusht, u nisëm për në Shqipëri. Kë e ka marrë Riza me vete në dy raste unë nuk e di. Kur e ka sjellë letrën Imer Maliqi, jemi nisur: Unë, Sali Rama, Smajl Beka, Shaban Alia nga Kuqishta, Riza Zymberi, gjithsej 5 a 6. Pas disa ditëve janë nisur edhe rugovasit e tjerë drejt te Sali Mani. Kështu më ka thënë Riza.

Për takimin tonë me anglezët në Shqipëri dhe për shkuarje në Greqi unë nuk kam dëgjuar kurrëgjë.

*\* Cili nga shokët tuaj ka vdekur kur keni shkuar në Shqipëri?*

- Për Zotin nuk di. Nuk ka vdekur askush nga shokët tanë, por, nuk di se prej kujt, kam dëgjuar se ka vdekur Manush Begu. Unë nuk di me kë ka ardhur Manush Begu as ku është fshehur.

Unë nuk e kam parë fare Manush Begun prej ardhjes së partizanëve, por nuk mund të betohem sepse më kujtohet e se e kam parë në Rugovë! Tani pendohem dhe po them se Manush Begu ka shkuar me mua nga Rugova. Askush nuk di ku është varrosur as ku ka vdekur. Ai është ndarë prej nesh dhe ka shkuar te Sali Mani dhe atje ka vdekur. Garantoj me jetën time se ka vdekur.

Në Shqipëri kemi mbetur tërë dimrin, por nuk e di emrin e asnjë vendi dhe asnjë mali. Së pari kemi qenë bashkë, e mandej Riza është ndarë. Me të kanë shkuar dy ose tre veta, por emrat e tyre i kam harruar! Me mua kanë mbetur: Bekë Rexhepi, Sali Rama, Malë Jusufi, Haxhi Imeri, Keq Sadria.

Riza Zymberi, me anë të njerëzve të vet, na ka furnizuar me drithë për tërë dimrin, ndërsa, kur na ka lënë Riza, kemi blerë ushqim dhe e kemi ndarë. Ai ka qenë rreth 4 orë e verës 2 orë larg nesh. Unë nuk kam shkuar në strehimoren e tij, kurse ai ka ardhur vetëm një herë në strehimoren tonë për të parë si jetojmë. Sali Rama ka qenë një herë tek ai, por nuk di saktësisht për këtë.

Askush nga ballistët e Shqipërisë, derisa ne kemi qenë atje, nuk ka ardhur te ne e as që jemi takuar ne me ndonjë grup atje.

Nga Shqipëria jemi kthyer në Rugovë ngase kemi pritur ndonjë amnisti dhe nga se kishim dëgjuar se ne nuk do të mund të qëndronim atje, prandaj më mirë dot ishte të gjendemi në vendin tonë. Ardhja jonë nuk ka qenë e lidhur me kurrfarë aksioni as me farë direktivash për punë në rajonin tonë. Askush para ardhjes sonë nuk na ka njoftuar për gjendjen e në Rrafshin e Dukagjinit dhe në Rugovë.

Nga Shqipëria jemi kthyer rreth Shëngjergjit të vitit 1946. Me mua janë kthyer Saliu, Keqa, Beka, Mala, unë Zhuka, gjithsej 6.

*\* Çka di për luftën në Shtedim?*

- Unë kam dëgjuar për atë luftë pas 10 ditësh. Për këtë më ka treguar Riza. Unë atëherë kam qenë ose në Murgash ose në Hajle. Garantoj se askush nga njerëzit e mi: Sali Rama, Rexhep Beka, Keq Sadria dhe unë, nuk ka marrë pjesë në atë luftë.

*\* Mirë, por ne e dimë se në atë luftë është plagosur Rexhepi?*

- Unë nuk di çka kam thënë, por më duket se është ashtu.

Më shumë kemi jetuar në terrenin e Malit të Zi: në Murgash, në terrenin e pyjeve të Jemesë – të ashtuquajturave pyje të Bongjonit. Derisa kemi qenë

në atë terren, te ne nuk ka ardhur askush nga çetnikët as që kemi pasur lidhje me ta.

*\* Kush dhe kur kanë ardhur te ju ndonjë nga grupet balliste?*

- Unë s'e kam parë kurrë se ka ardhur dikush as që jemi takuar me dikë. Bajram Ramën e njoh por unë nuk kam parë se ka ardhur ai dhe as nuk di se te kush ka ardhur.

Unë s'e kam dërguar kurrë askënd nga grupi im që të lidhet me grupe të tjera ose me ndonjë vend tjetër.

Manush Begun e ka sjellë dikush nga Shtupeli i Vogël pasi e kishte gjetur diku nga Shtedimi. Pse ka shkuar ky atje unë nuk e di. Ai është i arratisur dhe ka shkuar me të arratisur të tjerë e kanë hasur në të dhe e kanë sjellë te ne.

*\* Ti po thua se nuk je takuar me të huaj në Rugovë e Manush Begun e ke pranuar?*

- Porsa e kam pranuar jemi nisur për Shqipëri.

*\* Me kë keni biseduar për të shkuar në Greqi?*

- Me askënd. As që kemi biseduar ndonjëherë për këtë. Edhe sikur të kishim biseduar, kjo nuk do të realizohej. Dikush donte dikush s'donte. Sali Rama thoshte se sikur ta kishim dikë që do të na përcillte, do të shkonim. Se na ka thirrur dikush dhe se ka ardhur dikush për mua, mund të them se jo, për të tjerët nuk mund të garantoj. Kemi biseduar shpesh.

Ne takoheshim rastësisht kur ndaheshim. Por, kryesisht dihej se ku ishte secili e kërkoheshim dhe gjendeshim.

E njoh Demë Ali Pozarin. Ai nuk ka ardhur kurrë te ne. Ne jemi takuar ndonjëherë me të në bjeshkën mbi Deçan. Me të jemi takuar me ftesën që na ka dërguar me anë të një bariu. Ai na ka përcjellë ftesën gojarisht. Kemi shkuar Sadri Rama dhe unë. Ai na luste që ta merrim për të jetuar me ne në Rugovë. Ne i thamë se nuk mund ta pranojmë se ka brigada në Rugovë. Unë nuk e kam thirrur më dhe nuk e kam parë. Ne jemi kthyer të nesërmen.

*\* Pse ke thënë përpara se nuk e ke parë kurrë Demë Ali Pozharin prejse ka dalë kaçak?*

- Sepse më ke thënë se duhet të garantoj me kokë dhe unë nuk kam guxuar e mandej më ka rënë në mend se jemi takuar me të.

*\* Kush ju ka dhënë ndihma nga Peja?*

- E di për vete se nuk na ka ndihmuar askush. Për të tjerët nuk di.

*\* Kush ju ka ushqyer dhe ju ka ndihmuar nga fshatrat e Rugovës?*

- Secili jemi varur nga shtëpitë tona.

*\* Kush nga kaçakët fshihet sot në Rugovë?*

- Tash vetëm Rizë Zymberi dhe 3 veta gjithsesi. Të tjerë nuk ka.

*\* Ku i keni fshehur armët?*

- Një mortajë dhe një mitraloz “breda” me municion rezervë. Për këto di Sali Rama dhe ai do t’i sjellë.

Armët e tjera i kemi dorëzuar.

Çka ka Riza këtë s’e di askush. Nuk di as për armët e Islam Tabakut. Askush nga ballistët në Greqi nuk na ka shkuar.

*\* A konsideron ti, Zhukë Haxhia, se me këtë i ke thënë të gjitha dhe se nuk ke çka thua tjetër*

- Konsideroj se edhe se nuk kam fshehur kurrgjë prej atyre që kam ditur.

**Mori në pyetje – togeri**

**Ilija Bozhoviq (d.v.)**

**I fajësuar**

**\*I nënshkruar me shenjë të gishtit:  
Zhukë Haxhia**

**Punuar në Drejtorinë e Drejtoratit të Sigurimit Shtetëror (UDB-së)  
për Qarkun e Pejës, më 14 mars të vitit 1947 në Pejë.**

## **VAZHDIM I MARRJES NË PYETJE TË ZHUK HAXHISË, ME GJENERALIET SI NË PROCEDIMET E MËPARSHME**

Menjëherë pas okupacionit italian kanë ardhur në Rugovë dhe në Kuqishtë një kolonel italian dhe një shqiptar, e ishin me ta edhe disa oficerë. Atëherë mua më kanë emëruar si më kryesorin, kurse Rizë Zymberi u emërua sekretar politik. Kapobandë ishin: 1. Sali Rama, kapiten me 100 njerëz për rajonin: Smilevicë, Murgash-Skërbudaçë; 2. Sak Fazlia nga Koshutani, bajraktar i Moknës (është vrarë) dhe 3. Isuf Mehmeti, bajraktar nga Shtupeli i Vogël për rajonin e Kullës së Madhe në Moknë, i cili tash gjendet në shtëpi.

Kështu kemi punuar bashkërisht derisa kemi filluar të grindemi unë e Rizë Zymberi. Rizë Zymberi donte të komandonte në tërë Rugovën, kurse unë atëherë i thosha nuk ia jap fshatrat e mia (të fisit tim): Shtupelin e Vogël, Malajt, Pepajt, Drelën, Dugaivën dhe Joshanicën.

Me mua kanë qenë të lidhur këta kapobandë:

1. ISUF MEHMETI. Zëvendëskapobandë, do të thotë zëvendësi im ishte Tahir Abazi nga Drela, i cili kishte me vete 50 njerëz dhe e kishte rrogën 10 napolona. Ky ka vdekur. Kapobandë tjetër ishte Ramë Keqani nga Joshanica. Edhe ky kishte me vete 50 njerëz dhe e kishte rrogën 10 napolona, e tash gjendet në shtëpi.. Isuf Mehmeti gjithashtu kishte dy kapobandë. Këta ishin: Tahir Isufi nga Shtupeli i Vogël, i cili kishte 50 njerëz e 10 napolona në muaj (tash është në burg) dhe i dyti ishte Rrustë Sadria nga Malaj, i cili gjithashtu kishte me vete 50 burra. (Është vrarë).

Kapobandë të tjerë ishin:

Te Sali Rama:

Keq Sadria nga Koshutani, me 50 njerëz e 10 napolona rrogë;

Ali Kadria nga Koshutani, me 50 njerëz e 10 napolona rrogë.

Te Sak Fazlia:

Imer Muja, nga Koshutani, me 50 njerëz e 10 napolona rrogë;

Sokol Bajrami nga Pepaj, me 50 njerëz e 10 napolona rrogë.

Theksoj se ky Sokol Bajrami ishte nga Pepaj, që është fshati im dhe fisi im, por unë e kam lënë që të jetë te Sakë Fazlia, sepse unë kisha më shumë se 200 njerëz, kurse Saka nuk i kishte 100 dhe unë ia kam dhënë këtë që të kishte edhe ai 100 njerëz që të mund të ishte kapobandë.

HAXH MUSTAFA kishte nënkapobandët:

Din Zeqa nga Reka e Allagës, i cili ishte njeri shumë i pasur, më i pasuri në Rugovë, kishte 50 njerëz.

Edhe tjetri ishte nga Reka e Allagës, por nuk më kujtohet emri. (Sipas deklaratës së Sali Ramës, ky quhej Sadik Selimi nga Reka e Allagës).

Në Rugovë kanë qenë gjithsej dy bajraktarë:

Isuf Mehmeti nga Shtupeli i Vogël dhe Kadri Bajri, i cili ka qenë bajraktar në kohën e Turqisë dhe ka vdekur, kurse nipi i tij Imer Muja ka qenë bajraktar, por, pas okupacionit italian, fshati i tyre e ka zgjedhur bajraktar Sakë Fazlinë, sepse Imer Muja nuk u ka pëlqyer.

Spektori që kishim ne për ta ruajtur kufirin e “Shqipërisë së Madhe”, shtrihet prej Çakorit në Mokne-Klagji-Murgash e deri në Smilevicë përmbi Skrobudaçë. Kështu ka qenë në fillim, e mandej ne e kemi lëshuar Çakorin të cilin e mbanin të tjerët, zakonisht ushtria italiane.

Në sektorin tim në Mokne dhe në sektorin ku ka qenë Rizë Zymberi, ka pasur luftime. Tek unë një natë ose dy net, kurse tërë kohën tjetër kemi ndenjtur duke ruajtur kufirin. Ndërkaq, te Rizë Zymberi shpeshherë ka pasur luftime, madje edhe natën. Përveç tanëve, frontin përballë Malit të Zi dhe

matanë kufirit e kanë mbajtur edhe burrat e Rrafshit, por këta ndërroheshin vazhdimisht krye 10 ose 15 ditëve. Po ashtu ndërroheshin edhe rugovazit tanë. Ne kapobandët shkonim më rrallë në shtëpi, sepse duhet të ishim vazhdimisht me ushtrinë tonë, ngase, në qoftë se do të shkonim ne nuk do të rinin as këta të tjerët.

Në sektorin tim në Mokne gjatë verës ishte një kolonel shqiptar, nuk ia di emrin, por ai shkonte në Plavë. Tek unë rrinte gjithnjë një kapiten shqiptar, i cili quhej Bibë. Ai gjithnjë merrte urdhëresa, të cilat ne ua përcillnim njerëzve tanë për secilën bandë.

Unë, si analfabet, nuk e di a e njoftonin ata këtë dhe a i komandonte ai këta e të tjerët.

*\* Sa kohë ke qenë ti më kryesori në Rugovë?*

- Në fillim, kur i kemi marrë pushkët që të luftojmë, unë kam qenë më kryesori rreth gjashtë muaj, e mandej ka qenë Riza njësoj si unë.

*\* Çfarë grade ke pasur ti dhe çfarë grade ka pasur Rizë Zymberi, e çfarë grade kanë pasur kapobandët e tjerë, si Sali Rama?*

- Unë nuk kam pasur grada e as të tjerët, por kam qenë vetëm kapobandë. Le të vijë kush të dojë dhe le të më thotë se kam pasur gradë e mandej më dënoni si të doni.

*\* Po ta tërheq vërejtjen që të pranosh, që mandej të mos bëjmë ballafaqimin?*

- Unë edhe më tutje qëndroj pranë deklaratës së mëparshme se as unë as të tjerët nuk kemi pasur grada.

**E mori në pyetje**

**(Gojko Medenica)**

**I pandehuri – analfabet**

**(me shenjë gishti)**

**(Zhukë Haxhia)**

**PROCESVERBAL MBI BALLAFAQIMIN  
E TË PANDEHURVE ZHUKË HAXHIA E SALI RAMA,  
të dy nga Rugova**

*\* I pandehuri Zhukë Haxhia, a e njeh ti këtë njeri që është para teje?*

- E njoh, quhet Sali Rama. është rugovasi im.

*\* I pandehuri Sali Rama, a e njeh ti këtë njeri që është para teje?*

- E njoh mirë, quhet Zhukë Haxhia, nga një fshat i afërm me fshatin tim.

*\* I pandehuri Zhukë Haxhia çfarë marrëdhëniesh ke me Sali Ramën?*

- Kam marrëdhënie të mira, nuk kam kurrfarë grindje me të.

*\* I pandehuri Sali Rama çfarë marrëdhëniesh ke me Zhukën?*

- Gjithashtu kam marrëdhënie të mira, kurrë nuk kam pasur grindje me të.

*\* I pandehuri Sali Rama, çfarë grade ke pasur ti në kohën e okupacionit si vullnetar kapoband?*

- Unë kam qenë kapoband i 100 njerëzve dhe kam pasur gradën e kapitenit. Se jam kapiten e dinë të gjithë fshatarët në Rugovë, e këtë ma ka komunikuar koloneli italian.

*\* E çfarë grade ka pasur Zhukë Haxhia, çka ka qenë ai si udhëheqës?*

- Zhuka, në fillim, ka qenë kapobandi më i vjetër dhe të gjithë në kapobandët e tjerë kemi qenë nën komandën e tij. Ai e ka pasur gradën e majorit, përveç që e kishte emërtimin kapoband, por, pas një viti, kanë filluar të grinden Xhukë Haxhia dhe Rizë Zymberi rreth kësaj sepse Rizë Zymberi ishte kapiten, e njëkohësisht edhe komisar politik i partisë fashiste. Dhe Rizë Zymberi kundërshtonte. Që të mos ndodhte deri te rebelimi, koloneli italian e emëroi major edhe Rizë Zymberin, kështu që tash edhe Zhuka edhe Riza ishin majorë.

*\* Kur ju kanë njoftuar se keni këto grada?*

- Më vonë kur i kemi mbledhur nga 100 njerëz dhe kur kemi pasur një numër më të madh njerëzish (600).

*\* Zhukë, a është e vërtetë kjo që po thotë Sali Rama?*

- Në fillim unë kam qenë kapobandi më i vjetër, por nuk kam mbajtur as nuk kam pasur gradën e majorit. Riza, në fillim, ka qenë nën komandën

time, e më vonë edhe ai është bërë i barabartë me mua dhe ka pasur njerëzit e vet e unë të mitë, do të thotë unë kam pasur 6 fshatra e ai kishte 7 fshatra.

**I ballafaqoi**  
(Gojko Medenica, d.v.)

**Të pandehurit**  
**1. Zhukë Haxhia – analfabet**  
(Shenja e gishtit)  
**2. Sali Rama, d.v.**

### VAZHDIMI I MARRJES NË PYETJE TË ZHUKË HAXHISË

*\* Pse ti, Zhukë, po mbrohesh nga grada kur këtë e dinë të gjithë e jo vetëm Sali Rama që po ta thotë këtë ndër sy?*

- Unë sikur të kisha pasur gradë, do të tregoja, por kam qenë vetëm kapoband, në fillim më i vjetri për tërë Rugovën e mandej e kam ndarë këtë me Rizë Zymberin, i cili ka qenë i barabartë me mua. Sikur po e pranoj se kam qenë kapobandi më i vjetër do ta pranoja edhe se kam pasur gradë.

*\* Na trego për rastin e vrasjes së dy grupeve partizane në Banxhë dhe Pepaj, përkatësisht në Rekë të Allagës?*

- Kur është vrarë në Ajllë një grup në të cilin ka qenë një vajzë, unë kam qenë në shtëpi. Mandej flitej se vajzën e ka vrarë Shaqir Ibra nga Shkreli (i dënuar me vdekje), e aty kanë qenë ushtria shqiptare dhe vullnetarët e Rizë Zymberit, sepse Riza e ka pasur Koshutanin dhe Shkrelin.

*\* E grupi i dytë, që është vrarë në Rekën e Allagës ka qenë juaji dhe i Pepajve?*

- Unë nuk di për këtë, sepse kjo është pesë orë larg shtëpisë sime, por kam dëgjuar se janë vrarë vetëm dy veta, e jo më shumë si po thoni ju. Për këta nuk di kush i ka vrarë.

Ata që e kanë vrarë grupin e parë janë udhëhequr nga kapiteni shqiptar, emrin e të cilit unë nuk e di (e di Sali Rama). Ai ka qenë katolik nga Shqipëria, nuk e di as nga cili vend, por do ta dijë këtë Saliu, sepse ai kalonte mirë me të.

*\* Ti, Zhukë, ke qenë kapobandi më i vjetër, pse, pra, ke lejuar që t'i vrasin këta partizanë?*

- Unë nuk kam ditur kurrë për këtë, sepse nuk kam qenë në pratrullë, e atëherë as nuk kam mundur të bëj gjë, sepse askush nuk më ka pyetur, kurse atje kanë qenë Rizë Zymberi dhe ky kapiteni shqiptar.

*\* Na thuaj diçka për shkuarjen tënde në takim në Bogiq, e ku keni mbajtur një këshillim për të shkuar në Greqi, dhe kush ka qenë i pranishëm në atë takim?*

- Unë nuk kam qenë në atë takim dhe nuk mund të di kush ka ardhur as që më ka thirrur mua kush në atë takim.

*\* Kujtoje pak atë takim kur ke qenë atje ti me nipin tënd Bekë Rexhepin?*

- Unë s'kam qenë kurrë me Bekë Rexhepin, por kam qenë një herë me Sali Ramën në bjeshkën e Bellës dhe te Demë Ali Pozhari dhe askush tjetër s'ka qenë me ne. Aty, te Demë Alia, kemi gjetur 5 a 6 njerëz, prej të cilëve nuk e kam njohur asnjërin. Te Dema jemi ndalur nja 2-3 ditë e jam kthyer për në Rugovë. Më kanë përcjellë dy njerëz të Demës, kurse Sali Rama ka ndenjtur edhe disa ditë te Dema, sepse ishte pak i dobët (me shëndet) dhe nuk mund të kthehej menjëherë. Ne kishim shkuar te Demë Alia për të parë çka mendon ai për dimrin që po vinte, sepse ishte vjeshtë, dhe që të rrinim pak tek ai për t'i fshehur gjurmët, që të mos dihej se ku jemi. Por, pasi tek ai nuk kishte vend, u ktheva mbrapa në Rugovë.

*\* Ne po të pyesim prapë që të na përgjigjesh kur ke qenë ti me Bekë Rexhepin në bjeshkën e Bogiqes, në vendin Koshuticë, afër kufirit shqiptar, në takimin e ballistëve më 28 gusht të vitit 1946, ose, që ta kesh më të qartë, në vjeshtë kur fillon të piqet misri?*

- Jo, nuk kam qenë në kurrfarë takimi.

**E mori në pyetje**

**(Gojko Medenica, d.v.)**

**I pandehuri – analfabet**

**(Shenja e gishtit)**

**(Zhukë Haxhia)**

## VAZHDIMI I MARRJES NË PYETJE TË ZHUKË HAXHISË

*\* Ne kemi ditur për shkuarjen tënde në takim me prijësit e tjerë ballistë në Bogiqe: Ramë Mujën nga Shqipëria, Adem Shabanin nga Plava, Demë Alinë nga Pozhari, Mehmet Rashkocin, Ramë Binakun, Lan Peqinin nga Plava, ku ju kishte thirrur Muharrem Bajraktari me anë të Ejup Binakut, dhe të tërheqim vërejtjen që të na flasësh për atë takim.*

- Është e vërtetë se kam shkuar në atë takim unë bashkë me Bekë Rexhepin, nuk e di tamam datën, por ka qenë fillimi i vjeshtës, dhe atje jam takuar me të arratisurit: Ramë Muja, Demë Ali Pozhari, Adem Shabani, Lan Peqini, Mehmet-agë Rashkoci; nuk më kujtohet a ka qenë edhe Ramë Binaku. Këta kanë qenë prijës ballistë dhe secili kishte me vete nga disa njerëz e gjithsej ishin rreth 40 të arratisur. Qëllimi i këtij takimi ishte që të këshilloheshim për të shkuar nga ky terren në Greqi. Këtë takim, si kam qenë i informuar unë, e kishte konvokuar Muharrem Bajraktari, por ai nuk kishte ardhur në takim e pse unë nuk e di. Di vetëm se Ramë Muja kishte marrë nga Muharremi një letër, në të cilën i shkruante që të merrej vesh me një katolik në Mirditë, që e kishte emrin Sokol. Por nuk di se çka shkruante tjetër në atë letër. Kur jemi tubuar në vendin e caktuar, boshnjakët e mbanin rojën, sepse ky ishte terreni i tyre, dhe, papritmas, u dëgjuan pushkët e boshnjakët e sollën një partizan të zënë rob, të cilin deshën ta pushkatojnë. Unë këtu jam angazhuar që të mos pushkatohej ky partizan, sepse ai, xhaxhanë e vet, e kishte ballist dhe unë u luta e nuk lejova që të pushkatohej, megjithëse Ramë Muja deshi ta pushkatonte duke thënë se ai, nëse e lirojmë, do t'u tregojë partizanëve ku jemi. Kah mbrëmja e liruam këtë partizan dhe menjëherë u nisëm në drejtim të Shqipërisë që të mos na gjenin partizanët, sepse dinim se ky do t'u tregonte ku jemi. Shkuam në malet e Gashit (në Shqipëri), dhe aty fjetëm një natë dhe ndenjëm një ditë. Prej aty vazhduam nëpër Tropojë në një mal tjetër, që nuk ia dinim emrin, sepse aty nuk kisha qenë kurrë më parë. Prej këtu Ramë Muja i dërgoi boshnjakët me Lan Peqinin që të mblidhnin misër nëpër ara, por ata hasën në pusi dhe u dëgjuan të shtëna. Ishte natë dhe këta u kthyen mbrapa me dy malësorë, të cilët e dinin rrugën, e ishin nisur me Lan Peqinin për të vjedhur. Këta na treguan çka kishte ndodhur. Ne ndenjëm këtu derisa zbardhi drita e mandej u ndamë.

Prej këtu, unë me Demë Alinë dhe Mehmet Agën, u kthyem deri te kufiri ynë, e mandej Dema dhe Mehmet Aga thanë se do të rrinë te disa miq, kurse unë me Bekë Rexhepin prej aty e vazhduam rrugën për këtu dhe erdhëm në Rugovë.

*\* Çka keni vendosur në këtë takim me krerët ballistë: për të shkuar më tutje dhe për t'u lidhur me Muharrem Bajraktarin?*

- Në mbledhje Demë Alia tha që të kalojmë në Shqipëri nëpër Has ku e ka një mik goran dhe të përgatisim ushqim për 5 ditë për të kaluar në Greqi.

*\* Prej nga Dema e njihte këtë goran dhe si quhet ai?*

- Dema tha se e njeh sepse atje e kishte kaluar dimrin e si quhej, nuk e dinte.

*\* Pasi keni vendosur të shkoni në Greqi, pse pra jeni shpërndarë pas betejës së parë?*

- Sepse Dema e dërgoi djalin e vet bashkë me një njeri që ta kërkonte atë goranin, e këta u kthyen pa e pas gjetur këtë njeri që duhej të na printe në rrugë. Përpos kësaj, kishim mbetur pa bukë dhe ndodhi kjo betejë e mandej ne u ndamë dhe, si thashë, unë dhe nipi im Beka u kthyem mbrapa në Rugovë.

*\* Na thuaj kush të ka njoftuar ty që të shkosh në atë takim?*

- Mua më ka gjetur një bari dhe më ka thënë se Dema më ka çuar fjalë që të shkoj tek ai sepse duhet të kalojmë në Greqi.

*\* Kush ka qenë ai bari dhe si të ka gjetur ai, si quhet ai, do të thotë kjo se ai paska ditur për ty?*

- Unë kam kthyer në katundin Mishevc për të marrë bukë në një kasolle, e cila nuk e di se e kujt ishte, dhe aty më kanë thënë se Demë Alia ka porositur që, nëse dua të shkoj në Greqi, sonte ose nesër duhet të mbërrij në vendin ku kam qenë më parë tek ai, dhe m'i ka caktuar dy vende afër malit të tij. Po atë natë unë kam vazhduar me Bekë Rexhepin që të takohem me Demën, megjithëse Bekë Rexhepi më ka thënë që të mos shkoj, sepse me siguri do të shkonim kot se Dema mund të na mashtrrojë.

*\* Si i ke lënë rugovasit e tjerë, mbase nuk ke menduar ta shpëtosh vetëm veten - pa u kujdesur për ushtarët e tu.*

- Unë atëherë, në atë moment, nuk kam pasur lidhje me rugovasit e tjerë, e pasi Dema më kishte porositur kështu shpejt e shpejt, jam nisur pa marrë parasysh të gjithë të tjerët.

*\* Si po del nga deklarata jote e sipërme, ky njeri, tek i cili ta ka dërguar lidhjen Dema, ka qenë jataku yt. Na thuaj kush është ai dhe si quhet?*

- Unë nuk di si quhet ai. Ai është poshtë nga rrafshi, unë i kam thënë se jam Zhukë Haxhia e ai s'ka guxuar të ma thotë mua emrin e vet, por më ka dhënë bukë dhe më ka thënë të mos i tregoj askujt se ku e kam marrë bukën. Kështu më kanë thënë edhe fshatarët e tjerë kur kam marrë bukë prej tyre.

*\* Ti, Zhukë, ke thënë në takimin në Koshuticë se rugovasit e tjerë do të vijnë me Sali Ramën, si i ke porositur që të vijnë?*

- Unë nuk kam thënë ashtu, por kam thënë se. nëse nuk duan të nisen menjëherë, le të më presin dy a tri ditë, derisa unë të kthehem në Rugovë për të tjerët, por Dema nuk është pajtuar dhe ka thënë se nuk kemi kohë për të pritur e unë mandej kam mbetur që të shkoj vetëm me Bekë Rexhepin.

**E mori në pyetje**

**(Gojko Medenica, d.v.)**

**I pandehuri – analfabet**

**Shenja e gishtit**

**(Zhukë Haxhia)**

**Se kopja është identike me origjinalin verifikon**

**Sekretari i Drejtorisë**

**Dragi A. Janković**

**(Vula e Drejtorisë së Drejtoratit të Sigurimit Shtetëror të Ministrisë së Punëve të Brendshme të RFPJ – Pejë)**

